



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21 regjistër (JR)  
Datë 06.06.2024

Nr. 7 i vendimit  
Datë 22.01.2026

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Ina Rama</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Relatore</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

- shpalli në seancë gjyqësore publike, më datë 22.01.2026, ditën e enjte, në orën 16:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, vendimin për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 21/2024 (JR), datë 06.06.2024, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, z Klodjan Braho, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 743, datë 19.03.2024, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt

shqyrtimi, dëgjoji gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Gentian Hamiti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion gjyqtar, aktualisht i deleguar pranë Gjykatës Administrative të Apelit, i është nënshtuar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në funksion të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas së cilave:
  - 2.1. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit, dërgoi në Komision raportin me konstatimet se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
  - 2.2. AKSIK-ja, në zbatim të kërkesave të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka përcjellë raportin e Grupit të Punës nr. {\*\*\*} prot., datë 31.10.2017, me lëndë “*Dërgohet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti*”, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {\*\*\*}, datë 14.11.2023, në të cilin konstatohet *përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Gentian O. Hamiti*.
  - 2.3. KLGj-ja, pas rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dokumenteve të tjera ligjore të përzgjedhura, sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.
3. Në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar, Komisioni, pasi konkludoi se subjekti i rivlerësimit: (a) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (b) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (c) ka arritur një nivel të kënaqshëm kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, si dhe nga vlerësimi tërësor nuk u konkludua se kishte veprime e sjellje të tilla që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, bazuar në nenin 58, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 59, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 743, datë 19.03.2024, vendosi: “*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti, gjyqtar, aktualisht ushtron funksionin e tij si i komanduar pranë Gjykatës Administrative të Apelit*”.

## II. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

4. Kundër vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik Florian Ballhysa (në vijim “Komisioneri Publik”), i cili, duke sjellë paraprakisht në vëmendje të Kolegjit dy gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar me nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2023 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 11.01.2024, të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti, në Komision, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 49, pika 10 të ligjit nr. 84/2016, të cilat përbëjnë provë në këtë proces, çmon se ky vendim është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’iu paraqitur për shqyrtim, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Për këto arsye, Komisioneri Publik, bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4, pika 2, si dhe nenit 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, ka kërkuar që shkaqet e ankimit të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 84/2016, të vendosë: *Ndryshimin e vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti.*

5. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioneri Publik ka parashtruar shkaqet e ankimit si më poshtë.

*5.1. Në lidhje me të ardhura të deklaruara në shumën 800.000 lekë nga shitja e truallit me sip. 300 m<sup>2</sup>, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me përfitimin e shumës 800.000 lekë nga shitja e truallit me sip. 300 m<sup>2</sup>, rrethana të cilat duhen marrë në konsideratë në vlerësim tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vijim dhe të problematikave të tjera të konstatuara, për pasurinë truall 300 m<sup>2</sup>.*

*5.2. Në lidhje me fitimin e pronësisë së pasurisë truall me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, Delvinë, rrethanat e konstatuara, së bashku me gjetjet e tjera të trajtuara në vijim dhe në vlerësimin e kontrollit të figurës, lidhur me gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar, mbi dënimet e shtetasit A. H., person i përfshirë në këtë investim, duhen të vlerësohen nga Kolegji, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, mbi etikën dhe integritetin e magjistratit, si dhe referojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

*5.3. Në lidhje me pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja A. H. (M.): (i) apartament banimi me sip. 106 m<sup>2</sup>, në vlerën 50.000 euro; (ii) të ardhura nga aktiviteti privat familjar bujqësor në vlerën 53.000 euro; (iii) garazh me sip. 23,04 m<sup>2</sup>, në vlerën 500.000 lekë, Komisioneri Publik, në ankim, ka pretenduar se në kushtet kur në ankimin e vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, që i përket bashkëshortes së subjektit (e cila është subjekt rivlerësimi), ka arritur në përfundimin se znj. M., personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë dhe ligjshmërinë e burimeve të deklaruara për krijimin e tyre, në kushtet kur një pjesë e pasurive janë krijuar gjatë njohjes apo dhe bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe vlerëson se situata financiare e saj afekton subjektin e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar. Këto situata duhen çmuar nga Kolegji, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në vlerësim tërësor të procedurave, në funksion të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

5.4. Në lidhje me të dhënat e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë ABI Bank, duket se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta dhe të pavërteta mbi burimin/destinacionin dhe marrjen e shumës prej 2.500 eurosh nga z. A. B., të cilat, në procesin e rivlerësimit të z. Hamiti, mbeten deklarative dhe kontradiktore në raport me deklarimet e subjektit të rivlerësimit A. B., të provuara me deklarimet periodike të kohës. Mosdeklarimi i kësaj marrëdhënieje dhe përpjekja për ta shfaqur atë si huadhënie, konsiderohet si përpjekje e subjektit për të paraqitur ndryshe këtë situatë, për pasojë klasifikimin e saj, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe tregojnë për një sjellje të subjektit të rivlerësimit, e cila është e papranueshme për të pasur besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe duhet vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në raport me parashikimet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

6. Për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioneri Publik ka pretenduar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me mospasjen dijëni të dënimit të shtetasit A. H. nuk duken bindëse, dhe se rrethanat e dala në lidhje me marrëdhënien e tij me këtë shtetas, së bashku me gjetjet e tjera të trajtuara, duhet të vlerësohen nga Kolegji në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, nenit 75 të ligjit nr. 96/2016, mbi etikën dhe integritetin e magjistratit, dhe referojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
7. Për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioneri Publik ka pretenduar se vendimi i subjektit të rivlerësimit mbi caktimin e masës së sigurisë, duke urdhëruar gjykata pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ për bllokimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duket sikur merr tiparet e një padie civile të mirëfilltë, duke urdhëruar të paditurin të kryejë atë që kërkon paditësi të zgjidhet, rast që duhet vlerësuar së bashku me gjetjet e tjera në vlerësimin tërësor të procedurave në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

### **III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

#### **A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit**

##### *a) Juridiksioni i Kolegjit*

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin nga Komisioneri Publik të një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### *b) Legjitimimi i ankuesit*

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit

brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, u zhvillua në seancë gjyqësore publike.
11. Në seancën gjyqësore publike të datës 16.01.2026, në zbatim të përcaktimeve të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues vendosi kalimin procedural të ankuesit nga Komisioneri Publik Florian Ballhysa, te Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i pranishëm në seancë.
12. Në parashtrimet e tij përpara Kolegjit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, i qëndroi kërkimit të ankimit për ndryshimin e vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Po në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit, në përfundim të parashtrimeve, i kërkoi Kolegjit të rrëzojë si të pabazuar në fakte dhe në ligj ankimin e Komisionerit Publik dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, si një vendim i bazuar në një shqyrtim të drejtë, të plotë dhe në përputhje me standardet kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë procesin e rivlerësimit kalimtar. Së bashku me parashtrimet, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa akte shkresore<sup>1</sup>, të cilat kërkoi të merren në cilësinë e provave të reja, me qëllim shqyrtimin e plotë të rrethanave faktike lidhur me shkaqet e ankimit. Trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj. Gjithashtu, trupi gjykues vendosi të marrë kryesisht, në cilësinë e provës, aktet e gjendura në dosjen gjyqësore që i përket vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 59, datë 22.07.2025, dhënë për personin e lidhur A. H., që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë së këtij subjekti.
13. Në seancën e datës 22.01.2026, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho, deklaroi se në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të përmbajtjes së akteve të administruara dhe nivelit të provueshmërisë së tyre, në lidhje me shkaqet e ankimit, vlerësoi si më poshtë.
  - 13.1. *Lidhur me të ardhurat në shumën 800.000 lekë, të përfituara nga shitja e truallit me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, në Delvinë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me të ardhurat në shumën prej 800.000 lekësh dhe kohën e përfitimit të tyre është deklarim i saktë, në përputhje me përmbajtjen e kontratës së shitjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.02.2008, si dhe është pasqyruar në mënyrë të saktë si në deklaratën vetting, ashtu dhe në deklaratën para fillimit të detyrës.*

---

<sup>1</sup> Vërtetim nr. {\*\*\*/2024} prot., datë 06.08.2024, i shoqërisë "{\*\*\*}" ShA; -- vendimi nr. {\*\*\*}, datë 09.02.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit; vendimi nr. 59, datë 22.07.2025, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit; -- vendimi nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06. 2023, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**13.2.** *Lidhur me fitimin e pronësisë së pasurisë truall me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup> ndodhur, në Delvinë,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore për sjelljen në cilësinë e pronarit, për sa kohë vendimi gjyqësor nuk është vënë në ekzekutim dhe mosmarrëveshja civile është zgjidhur me marrëveshje midis palëve. Si rrjedhim, edhe për këtë shkak, nuk ekzistojnë rrethana që të mund të vlerësohen mbi etikën dhe integritetin e subjektit të rivlerësimit.

**13.3.** *Lidhur me pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit, znj. A. H. (M.),* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se shkaqet e ankimit të lidhura me pasuritë e deklaruara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit janë shqyrtuar tashmë në procesin gjyqësor të kësaj të fundit, i cili ka përfunduar me vendimin nr. 59, datë 22.07.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që ka vendosur pushimin e shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 605, datë 21.12.2022, të Komisionit. Për këtë arsye, nga Drejtuesi i Prokurorisë çmohet se shkaqet e ankimit lidhur me ligjshmërinë e pasurive të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë qenë objekt i një vendimmarrjeje përfundimtare të Komisionit dhe të Kolegjit, nuk mund të shërbejnë për marrjen e një mase disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti.

**13.4.** *Lidhur me shumën prej 2.500 eurosh të kredituar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit pranë ABI Bank në vitin 2009,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se rrethanat e konstatuara lidhur me këtë shumë të kredituar në llogarinë bankare të subjektit të rivlerësimit nuk mjaftojnë për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës apo se ka kryer sjellje që cenon besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

**13.5.** *Lidhur me kontrollin e figurës,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme çmon se në veprimet juridike që janë kryer në vitet 2008 dhe 2009, mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit A. H., që përkojnë me kohën kur z. Gentian Hamiti ushtronte funksionin e gjyqtarit, nuk janë veprime juridike që kanë krijuar ndonjë marrëdhënie interesi të re midis tyre, por me këto veprime juridike palët kanë zgjidhur marrëdhënien e tyre juridiko-civile të mëparshme. Nga Drejtuesi i Prokurorisë vlerësohet se veprimet e subjektit të rivlerësimit, në këtë rast, nuk përbëjnë ndonjë kontakt të qëllimtë dhe që nuk ka qenë në përputhje me detyrën e gjyqtarit.

**13.6.** *Lidhur me kriterin e vlerësimit profesional,* Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në referencë të parashtrimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, si dhe në kushtet kur gjykata më e lartë, konkretisht Gjykata Administrative e Apelit, me vendim nr. {\*\*\*}, datë 09.02.2023, e ka gjetur të drejtë vendimin e marrë nga subjekti i rivlerësimit lidhur me çështjen e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në datën 06.08.2019, me objekt “Marrjen e masës së sigurimit të padisë”, me palë kërkuese shoqëria “{\*\*\*}” ShPK dhe person i tretë “Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë”, për të cilën subjekti ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë dhe pezullimin e zbatimit të veprimit administrativ, si dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06.2023, të depozituar nga subjekti në Kolegj, nuk ka konstatuar shkelje disiplinore nga ana e subjektit të rivlerësimit në marrjen e këtij vendimi, vlerëson se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë të drejta dhe duhet të pranohen, duke mos u gjendur në kushtet e zbatimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke mbajtur në konsideratë konkluzionet e mësipërme, bazuar në parashikimet e nenit F, pika 7 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi nga Kolegji të vendosë: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit Gentian Hamiti.*

## **B. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit**

15. Trupi gjykues u njoh me ankimin e paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit të Komisionit që ka konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, me parashtrimet në seancë publike të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme dhe subjektit të rivlerësimit, si dhe me konkluzionet përfundimtare të seancës së datës 22.01.2026, nga të dy palët.
16. Në kushtet kur Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, si i vetmi disponues i mjetit procedural të ankimit, ka kërkuar para Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të Komisionit, duke mos e kundërshtuar më atë, tregon se për të nuk ekzistojnë më arsye faktike dhe ligjore për ndryshimin e vendimit të ankimuar, duke e lënë në këtë rast ankimin pa objekt. Në vlerësim të trupit gjykues, kjo situatë përbën në thelb një sjellje procedurale që barazohet për nga efektet me atë të heqjes dorë nga ankimi, sipas kuptimit të dhënë nga legjislatori për këtë institut procedural të parashikuar në nenin 463 të Kodit të Procedurës Civile.
17. Në rrethanat që deduktohet mungesë e interesit të ligjshëm, një vendimmarrje e Kolegjit e ndryshme nga ajo e kërkuar nga ankuesi, teorikisht, do ta bënte vendimin të cenueshëm, nëse do të ankimohej nga subjekti i rivlerësimit.
18. Për sa më sipër, në vlerësim të trupit gjykues, nuk kishte më lëndë procedurale për të vijuar kontrollin gjyqësor të vendimit objekt shqyrtimi, për sa kohë ankimi humbi objektin e tij dhe ankuesi interesin e ligjshëm në mbajtjen e ankimit.
19. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se pasoja e vetme ligjore për këtë situatë faktike procedurale është pushimi i shqyrtimit në Kolegji të çështjes së juridiksionit të rivlerësimit me nr. 21/2024, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti, pasi vijimi i gjyqimit për kontrollin e vendimit të Komisionit mbi bazën e një ankimi, të mbetur pa objekt dhe në mungesë të interesit të ligjshëm të ankuesit, do të përbënte cenim të procesit të rregullt ligjor.
20. Në funksion të qartësimit të pozitës procedurale të subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit nr. 84/2016, duke konsideruar natyrën e posaçme të këtij procesi, Kolegji gjen të nevojshëm të deklarojë edhe efektin ligjor që prodhon kjo vendimmarrje në raport me vendimin e Komisionit, objekt i ankimit të Komisionerit Publik. Në këtë kuptim, Kolegji konstaton se në zbatim të parashikimeve të nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, neneve 1, pika 2 dhe 44 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe neneve 451, shkronja “b” dhe 463 të Kodit të Procedurës Civile, vendimi i Komisionit nr. 743, datë 19.03.2024, ndaj të cilit ishte ushtruar ankimi, do të konsiderohet se merr formë të prerë në momentin që Kolegji merr vendimin për pushimin e shqyrtimit të kësaj çështjeje.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe nenet 451, shkronja “b” e 463 të Kodit të Procedurës Civile,

**VENDOSI:**

1. Pushimin e shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 21/2024, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 743, datë 19.03.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Gentian Hamiti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.01.2026, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*